



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:050214

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05614421

KPPP.nr. 2202/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Gjakova” SH.A., me seli në Gjakovë, rr. “UÇK”, nr.7, kundër debitorit G.B. N.P.T. “Bamirs” me seli në Rahovec, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 636/18 të datës 06.07.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjakë Radi, me seli të zyrës në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 24.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit G.B. N.P.T. “Bamirs”, ashtu që ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr. 636/18 i datës 06.07.2018, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjakë Radi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Gjakova” SH.A., me datë 06.07.2018 ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr. 636/18 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Ekstraktit nga librat e kontabilitetit i datës 05.07.2018, ashtu që është detyruar debitori që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, në emër të borxhit të papaguar për shërbimet e furnizimit me ujë, t’ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 1,606.12€ (një mijë e gjashtëqind e gjashtë euro e dymbëdhjetë cent) bashkë me kamatë vjetore duke e llogaritur kamatën vjetore të caktuar nga bankat komerciale në Kosovë, për mjetet monetare me afat të deponimit mbi një vit, duke e llogaritur kamatën nga data 05.07.2018 deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbartimit me duke kundërshtuar në tërësi borxhin e paraqitur përmes kartelës së kontabilitetit pasi sipas

debitorit është njoftuar edhe kreditori se orëmatësi nuk ka qenë duke bërë matjen e shpenzimeve të ujit. Andaj ka prapësuar urdhrin duke kontestuar në tërësi borxhin.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e ngritura nga debitori, duke theksuar se të njëjtat janë në tërësi të paargumentuara me prova relevante. Po ashtu ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e ngritura lidhur me punën e orëmatësit. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të lë në fuqi urdhrin përmbarimorë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “.*

Gjykata në rastin konkret vlerëson se ekstrakti nga librat e kontabilitetit i datës 05.07.2018 mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbarimor, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29, pika 1.2 të LPP-së, ngase në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit. Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që nga ekstrakti afarist, rezulton se borxhi prej 1,606.12€ është krijuar për periudhën kohore 2003 e deri në 2018, pra në fund të këtij ekstrakti është paraqitur shuma totale e mbledhur për periudhën e lartcekur ndërsa janë paraqitur vetëm faturat për periudhën 01.12.2017 deri me 01.07.2018.

Prandaj, në formën e paraqitur, ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2202/23, datë 24.04.2024.

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.